



Me

23 - 03 - 2018

P.nr. 2783/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par. I lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.208-2/16 të datës 01.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.04.01.2018, në prani të prokurorit të shtetit Sebahate Sinani dhe të akuzuarve, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

[REDACTED], nga fshati [REDACTED] K.Ferizaj, i lindur me datë [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal të letërnjoftimit [REDACTED]

[REDACTED], nga fshati [REDACTED] K.Ferizaj, i lindur me datë [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, moler, i martuar, babë i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal të letërnjoftimit [REDACTED].

JANË FAJTOR

me dt.05.02.2016, rrëth orës 11.00, në Shtime, në rrugën "Tirana", me qëllim që ti sjellin vetes dobi pasurore të kundërligjshme, në bashkëkryerje, e paraqitjen e faktave të rrëme, duke prezantuar si anëtarë të shoqatës humanitare "ndihmo për shërim", pa qenë aktivist të saj, kanë mbledhur pa autorizim ndihma humanitare nga qytetarët kinse për ti ndihmuar fëmijët në nevojë e konkretisht vajzës së sëmurë [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj.

me tē cilēn kanë kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 31 tē KPRK-së,

Andaj gjykata ne baze tē neneve 4,7,17,21,41,46,51,73 si dhe neni 365 tē KPRK-së, u shqipton:

SHQIPTON

Të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] secilit veç e vec

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200/dyqind/ euro tē cilin dënim ju lejohet që ta paguaj me këste mujore në afat prej 2/dy /muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 4/KATËR/MUAJVE, dënim ky që nuk do tē ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit).

Nëse dënimini me gjobë nuk mund tē ekzekutohet as në mënyra tjera tē parapara në nenin 46 tē KPRK-së, i njëjtë do ti shndërrrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Gjithashtu obligohen tē akuzuarit në emër tē paushallit gjyqësor tē paguaj shumën secili veç e vec me nga 30 /tridhjetë/€ në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënim tē ekzekutimit te dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr208-2/16 tē datës 01.11.2017, ka akuzuar tē akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] për veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 31 tē KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 04.01.2018, në të cilën shqyrtim të akuzuarit janë deklaruar fajtor për veprën për të cilën i ngarkon akuza, shprehin keqardhjen dhe janë penduar thellë për veprën e kryer duke theksuar se është hera e parë që bien ndesh me ligjin, i premtojnë gjykatës që në ardhmen do të jenë i kujdeshshëm dhe nuk do të përsëris vepra të tillë penale, lusin gjykatën që të iu shqiptoj një dënim sa më të bute.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga nen 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq janë deklarata e të pandehurit e datës 15.02.2016 dhe 16.02.2016, deklarata e dëshmitarëve të datës 22.02.2016, të bëhet shiqimi në autorizimin e datës 02.04.2015 dhe datës 26.11.2014 të bëhet leximi i vërtetimit mbi marrjen e përkohshme mbi sendet i datës 05.02.2016, si dhe të bëhet shiqimi ë shkresat e lëndës.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e pëershkrura më lartë, gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënitit dhe për këtë arsyë ka vazhduar me shqiptimin e dënitit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës mashtrimi nga nen 335 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënitit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, shprehin keqardhjen dhe janë penduar thellë për veprën e kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, nuk janë të evidentuar më parë si kryerës të veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përvëç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve.

Gjykata është bindur se dënim i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënit të parashihet ne dispozitat e nenit 41 që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përbaj personat e tjera nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

të KPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohen të akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili shumën prej 30 /tridhjetë /€ në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit te dhunë.


Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2783/17 me datë 04.01.2018

Zyrtare ligjore ,
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja,
Hakile ILAZI



Këshilla juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.